



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr.79, datë 06.07.2020

“PËR

MIRATIMIN E DHËNIES NË PËRDORIM NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR TË SIPËRFAQEVE NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË, KOMPANISË “AGE ERZEN” SH.P.K”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nën pikat 1.1 shkronja “b” dhe 1.2, shkronjat “a” dhe “c”, nenit 54, shkronja “e” dhe “e/1”, nenit 55, pikat 3 dhe 6, të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; Ligjit nr.7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; Ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar; Ligjin nr. 9693, datë 19.02.2007 “Për pyjet dhe kullotat”, i ndryshuar; Vendimit nr. 433, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish- komunave/ bashkive”; Vendimi nr. 822, datë 07.10.2015 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energji së elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, të ndryshuar, Udhëzimin nr. 1, datë 9.6.2016 të Ministrit të Mjedisit “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”; Vendimin nr. 28, datë 23.05.2016 të Këshillit Bashkiak “Për kalimin e funksioneve të mirëmbajtjes së rrugëve rurale, ujitjes dhe kullimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit, si dhe administrimit të pyjeve e kullotave, pranë Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit”; shkresës nr. 684/3, Prot., datë 16.06.2020 të Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit, Raportit Tekniko Ekonomik nr. 684/2, prot., datë 14.06.2020 të Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit, shkresa me nr. 17039/4, prot., datë 29.06.2020 e Drejtorisë së Përgjithshme të Projekteve Strategjike dhe Zhvillimit Ekonomik, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Miratimin e dhënies në përdorim nga fondi pyjor dhe kullor të sipërfaqeve prej 13 050 m², sipas specifikimit në Raportin Tekniko Ekonomik nr. 684/2, prot., datë 14.06.2020 të Agjencisë

së Parqeve dhe Rekreacionit, në pronësi publike të Bashkisë Tiranë, kompanisë “Age Erzen” sh.p.k, në funksion të projektit ndërtim dhe operimit “HEC – Hekal”.

2. Autorizohen Drejtoria e Përgjithshme Projekteve Strategjike dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit të ndjekin procedurat e nevojshme për lidhjen e kontratës në zbatim të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Projekteve Strategjike dhe Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

TONI GOGU